

**BASHKIA TIRANE**  
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: SALILLARI” shpk& “HELLAS SERVIS” shpk & ANALYSIS COMPUTER & SERVIS SA  
& “Klodioda” shpk

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat: “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e lartë  
monetar”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen  
dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. Operatori ekonomik "Ali Hyko " shpk  
Operatori ekonomik nuk ka paraqitur oferte

2. Bashkimi i operatorwve ekonomik BITUPAVE LLC & "ALBA-TRANS" shpk &  
ATELIER shpk & AGRI KONSTRUKSION shpk

NUIS - L 52317039 A & K 31931031 T & K31812012H &K 01725001 F

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve:

- 1 Periudha e Koncesionit 400 muaj
- 2 Nje tarife koncensioni prej 2 %
- 3 Një zbritje në Tarifat e terminalit, prej 5 %
- 4 Një ndarje të fitimit, prej 5%
- 5 Një Periudhë e ndërtimit të terminalit, prej 730 ditësh

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "SALILLARI" shpk& "HELLAS SERVIS" shpk &  
ANALYSIS COMPUTER & SERVIS SA & "Klodioda" shpk

NUIS-J 62903125 G & J 82312002 T & K 51813002H

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve:

1. Periudha e Koncesionit prej 33 vjet
2. Një tarifë koncensioni prej 2 %
3. Një zbritje në Tarifat e terminalit, prej 50 %
4. Një ndarje të fitimit, prej 5 %
5. Një Periudhë e ndërtimit të terminalit, prej 510 ditësh

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. Operatori ekonomik "Ali Hyko " shpk

2. Bashkimi i operatorwve ekonomik BITUPAVE LLC & "ALBA-TRANS" shpk & ATELIER  
shpk & AGRI KONSTRUKSION shpk

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. Operatori ekonomik "Ali Hyko" shpk
2. Bashkimi i operatorwve ekonomik BITUPAVE LLC & "ALBA-TRANS" shpk & ATELIER shpk & AGRI KONSTRUKSION shpk

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

Operatori ekonomik "Ali Hyko" shpk

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Koncesionit/PPP konstatoi se shoqëria "ALI HYKO" shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Dokumentat Standarte të Koncesionit për këtë procedurë.

---

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 680/704

---

---

**Buletini Nr. 20 datë 22 Maj 2017**

**Agjencia e Prokurimit Publik**

---

Ky fakt i konstatuar nga Komisioni u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës financiare dhe e dokumentacionit ligjor dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik "Ali Hyko" Sh.p.k s'kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Ofertës Financiare sipas Shtojcës 1 kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të koncesionit për këtë procedurë.

Bashkimi i operatorwve ekonomik BITUPAVE LLC & "ALBA-TRANS" shpk & ATELIER shpk & AGRI KONSTRUKSION shpk

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Ligjit nr.125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", (i ndryshuar), nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe dokumentave të koncesionit të

---

miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim Operatorësh ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Në procedurën e Koncesionit/PPP të mësipërm ka dorëzuar ofertën ekonomike Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "Bitupave LLC & Agri Construction shpk & Alba-Trans shpk & Atelier shpk. Bashkimi i shoqërive të mësipërme ka paraqitur në sistemin elektronik Kontratën për Bashkimin e përkohshëm të Shoqërive me nr. 1145 Rep dhe 183/3 Kol në të cilën specifikohet se kontributi i shoqërisë Bitupave LLC degë e shoqërisë së huaj me NIPT L52317039A do të jetë dhe do të llogaritet në masën 45%.

Komisioni i koncesionit/PPP gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në mënyrë elektronike nga bashkimi i operatoreve ekonomik konstatoi si më poshte vijon Operatori ekonomik Bitupave LLC si dege e shoqërisë së huaj ne Shqiperi ne plotesim te kriterëve te vendosura nga AK ka paraqitur dokumentacionin e shoqërisë mëmë, gjatë shqyrtimit të të cilit u konstatauan parregullsi te cilat janë reflektuar gjithashtu dhe ne proces verbalin e shqyrtimit te ofertave.

Shoqëria Bitupave LLC degë e shoqërisë së huaj ka paraqitur në sistemin elektronik të agjensisë së prokurimit publik Ekstraktin e dhomës së tregëtisë (chamber of commerce) të shoqërisë mëmë DE LOOIMOLEN Beheer B.V, në ekstraktin në fjalë u vunë re se ka mospërputhje në datat e lëshimit.

2.Në ekstraktin e Dhomës së Tregëtisë është deklaruar se shoqëria DE LOOIMOLEN Beheer B.V ka 0 punonjës, ndërkohë që listpagesat e deklaruara në tender të shoqërisë mëmë DE LOOIMOLEN rezulton që numri i punonjësve të jetë mbi 300.

3.Rezulton se anëtari i bordit të shoqërisë mëmë DE LOOIMOLEN Beheer B.V (referuar ekstraktit të lëshuar nga dhoma e tregëtisë) është Z. Hendrik Jan Maria, ndërkohë që nuk kuptohet se kush është roli dhe pozicioni i Z. George Wilhelm Fokker në kompaninë mëmë DE LOOIMOLEN Beheer B.V, më saktë në firmosjen e punëve të ngjashme dhe deklaratave (punë të ngjashme të cilat janë kryer nga kompania mëmë). Sqarojmë se Z. George Wilhelm Fokker figuron nga ekstrakti i shoqërisë së degës Bitupave LLC të jetë përfaqësues i saj dhe jo i shoqërisë mëmë.

4.Në kontratat e ngjashme të paraqitura në sistemin elektronik të agjensisë së prokurimeve publike si më poshtë:

a) Ndërtimi i rrugës Noord-Holland and Utrecht/ Rruga e re Oost-Netherland/Autostrada Zuid-Holland dhe mirëmbajtja, Formulari Specifik i Përvojës për këtë objekt është firmosur nga Z. George Wilhelm Fokker nën cilësinë e përfaqësuesit të Bitupave degë e shoqërisë së huaj në Shqipëri, ndërkohë që periudha e kontratës së ngjashme daton më parë se regjistrimi i degës në Shqipëri ( pra dega në periudhën e lidhjes së kontratës së ngjashme nuk ka qënë regjistruar si subjekt në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve)

Komisioni i Koncesionit/PPP në zbatim të Ligjit nr.125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, të Ligjit Nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,Neni 66 “Shqyrtimi dhe Vlerësimi i Ofertave” pika 2 i cili shprehet “Në rast se Komisionit i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve , afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve, verifikoi në mënyrë elektronik dokumentacionin e shoqërisë mëmë të noterizuar pranë noteres Mr. Marjolin Jolande Woldendorp zëvendësuese e noteres Mr. Aletta Frederika Laarberg –Trynes.Komisioni i Koncesionit i dërgoi email noteres e cila rezulton të ketë noterizuar të gjithë dokumentacionin e shoqërisë mëmë me seli në Hollandë, duke i kërkuar të vërtetojë nëse dokumentacioni që mbante firmën e saj ishte i saktë apo jo.

Noterja e cila figuronte që kishte firmosur dokumentat ktheu përgjigje me email duke na sqaruar se firma e vendosur në dokumenta nuk ishte e saja , vula gjithashtu ishte e parregullt dhe se Znj. Mr. Aletta Frederika Laarberg –Trynes nuk është notere e cila ushtron aktivitetin në qytetin e Nijmegen por ajo ushtron aktivitetin e saj si notere vetëm në Montferland.

Nga sa mësipër komisioni i koncesionit konstatoi se operatori ekonomik “Bitupave” LLC ka paraqitur dokumenta te rreme me qellim kualifikimin.  
Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga BITUPAVE LLC shpk lidhur me shtojcën 9 , është i pasaktë , për rrjedhojë i pavlefshëm

\* \* \*

Bashkia Tirane lajmëron se oferta e paraqitur më datë 04.04.2017 nga SALILLARI” shpk& “HELLAS SERVIS” shpk & ANALYSIS COMPUTER & SERVIS SA & “Klodioda” shpk Me adresw:Rruga Bilal Sina, Pll Salillari, shk 3, kati I parw, 1027, Tiranw për marrjen me koncesion te objektit “Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë” është pranuar.

Afati i negociimit te Kontrates tuaj do te jete 3 (tre) muaj

Ofertuesi "SALILLARI" shpk & "HELLAS SERVIS" shpk & ANALYSIS COMPUTER & SERVIS SA & "Klodioda" shpk kërkohet t'i paraqesë Bashkia Tirane dokumentet e mëposhtme:

---

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 682/704

---

**Buletini Nr. 20 datë 22 Maj 2017**

**Agjencia e Prokurimit Publik**

---

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Vecanta të Kontratës Koncesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.  
Dokumenta Standarde të Koncesionit\Partneritetit Publik Privat
- Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentat Standarde të Procedurës Konkurruese. Sigurimi duhet të paraqitet jo më vonë se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
- Dokument bankar që vërteton pagesën e kryer për shpenzimet e publikimit dhe shpenzimet e konsulencës së specializuar (në rast se ka). Kjo pagesë do të kryhet para fillimit të negociatave.
- Në rast se, terhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

Autoriteti kontraktues; Bashkia Tirane

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.04.2017

Ankesa: Nuk ka patur ankesa